

Termat e Referencës

për Hulumtimin/Anketimin “Urbanizmi në Prizren”

Projekti : “Qytetet Gjithëpërfshirëse - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje”

Informata rreth projektit:

Projekti synon të sjellë komunitetin në qendër të proceseve të planifikimit urban në komunën e Prizrenit. Përmes mobilizimit të komunitetit në nivel të lagjeve dhe të fshatrave projekti është një përpjekje për të përmirësuar planifikimin urban në një nivel gjithëpërfshirës. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të inkurajojë pjesëmarrjen e grupeve të komunitetit (grupeve të nën-përfaqësuar dhe në nivel të lagjeve) në proceset e planifikimit urban në Prizren. “Qytetet Gjithëpërfshirëse...” synon ti identifikojë dhe ti përkthejë nevojat e komunitetit dhe interesat e tyre në plane të qëndrueshme dhe të zbatueshme urbane, të krijojë dhe të fuqizojë grupet e komunitetit në çdo lagje urbane të Prizrenit dhe në fshatra të Prizrenit si dhe të mbikqyrë zbatimin e Rregullores për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urban. Aktivitetet kryesore të projektit përmes të cilave do të implementohen objektivat e projektit janë:

- Takimet e rregullta me lagjet/banorët,
- Punëtoritë e vizionimit,
- Performancat/intrvenimet publike,
- Hulumtimi,
- Aktivizmi ndaj autoriteteve,
- Avokim,
- Monitorimi i qeverisë lokale,
- Dokumentimi dhe
- Konferenca Vjetore.



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

Hulumtimi/Anketimi “Urbanizmi në Prizren”

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike:

1. Diskutimi me stafin e projektit rreth konceptit përfundimtar për realizimin e hulumtimit/anketimit
2. Përpilimi i përbashkët i pyetësorit dhe përcaktimi i mostrës
3. Analiza dhe shfrytëzimi i materialeve dhe raporteve të ofruara nga EC Ma Ndryshe
4. Konsultimi i vazhdueshëm me stafin e projektit rreth realizimit të punëve
5. Përgatitja dhe shtypi i pyetësorëve (min.800 copë)
6. Anketimi i më së paku 800 respondentëve në Prizre dhe rrethinë dhe përsëritja e anketimeve në rastet që nuk e kalojnë vlerësimin e cilësisë dhe validitetit
7. Futja e të dhënave, përgatitja e statistikave, analiza deskriptive e të dhënave të dala nga intervistat
8. Përgatitja e raportit cilësor analitik

Kohëzgjatja:

Aktivitetet e lartëshënuara duhet të përfundohen më së largu deri në 5 nëntor 2017.